

VENDIM
Nr.153, datë 13.2.2008

**PËR ZËVENDËSIMIN E PERSONIT TË KONTAKTIT NË MARRËVESHJEN, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË
MICROSOFT CORPORATION, PËR PROJEKTIN E PARTNERITETIT STRATEGJIK NË
FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.362,
DATË 20.6.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë Microsoft Corporation, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit, miratuar me vendimin nr.362, datë 20.6.2007 të Këshillit të Ministrave, në pikën 7, “Kontaktet” fjalët “...qeveria, z.Etion Kapedani, drejtor IT, (Teknologjia e Informacionit), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,...” zëvendësohen kudo me “...qeveria e Republikës së Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, drejtori...”.

2. Pika 2 e vendimit nr.362, datë 20.6.2007 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha